



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"CHARLES TELFORD ERICKSON"
Golem — Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0682063499

Nr. 93 prot

Golem më 09, 03, 2026.

Lenda: **Njoftim per vend pune te lire.**

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore

Drejtoria e Maredhenieve me Publikun

Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar, vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive", i ndryshuar, udhëzimit nr.4, dt.18.08.2025, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar. Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson" Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit të punësimit për pozicionin:

1 (nje) Punetor i Bazes Prodhuese te Shkolles me pozicion: Punetor i Bazes Prodhuese (Mjelese) me kohe te plote.

1. Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posacme.

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kriteret:

Kritere të përgjithshme:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën.
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e veprave penale.
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.

f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) Të ketë nivelin arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale, në fushën në shpalljen, për pozicionin perkates.
- b) Të ketë përvojë në punë të paktën një vit sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin perkates.

2. Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi.
- c) Kartën e identitetit
- d) Diplomën;
- e) Librezën e punës;
- f) Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 25 . 03 .2026

3. Vlerësimi i kandidateve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, dt.27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", I ndryshuar

Drejtör

Matilda Canaku

